

TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Shtator 2021

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	0%
Komision Administrimi në vit	1.25%
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.


Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.


Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.09.2021

Vlera Neto e Aseteve	45,527,390,451
Numri i investitoreve	27,734
Cmimi i Kuotes	1,569.4624
*Kthimi vjetor nga investimi (30.09.2020 – 30.09.2021)	2.18%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Shtator 2021



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuenca një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Ne % te Aseteve te Fondit

Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	3.98%
Depozita & Llogari rrjedhese	9.03%
Bono Thesari	23.71%
Obligacione Thesari	63.28%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 45.5 miliardë në datë 30 Shtator 2021.

Zhvillimet dhe ecuria e normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare gjatë muajit Shtator

Situata e krijuar nga rritja e numrit të infektuarëve po shkakton pasiguri në të gjithë botën. Në zonën Euro, të vaksinuar plotësisht janë rreth 60% e popullsisë, ky nivel vaksinimi nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar rritjen e numrit të infektimeve në Vjeshtë. Pas një rimekembje të shkëlqyer gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, të dhënat më të fundit ekonomike shënuan një ngadalësim të ritmit të rimëkëmbjes në të gjithë botën.

Ne Shqipëri gjithashtu numri i të infektuarëve vazhdon të rritet ndjeshëm për shkak të variantit Delta, por nga ana tjetër procesi i vaksinimit po kryhet me ritme të shpejta.


Asetet e Fondit Prestigj janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve. Kështu investimet e fondit nuk kanë lidhje direkte me tregjet ndërkombëtare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm sic janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.

Përgjatë muajit Shtator në tregun vendas normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare ishin të qëndrueshme, nuk pesuan ndryshime të rëndësishme në krahasim me muajin paraardhës.

Yield-i i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 1.77% i pandryshuar në krahasim me ankandin e muajit Gusht. Yield-i i Bonos 3 mujore rezultoi në 0.93% duke u rritur me 0.07% në krahasim me ankandin e fundit.

Ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar në LEK rezultoi në 2.20%, i pandryshuar në krahasim me normën e ankandit paraardhës. Për sa i përket obligacioneve afatgjate, u zhvillua obligacioni 7-vjeçar i cili rezultoi në 4.01% duke rënë vetëm me 0.01% krahasuar me ankandin e fundit të organizuar në Qershor. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit referencë 5-vjeçar i cili rezultoi në 3.453%, duke rënë me 0.06% krahasuar me ankandin e fundit të muajit Korrik.

Grafiku më poshtë jep një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Shtator 2020 – Shtator 2021. Për obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yields fikse të perlllogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Shtator.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Shtator 2021

Fondi Prestigj vijon të ketë një performancë të mirë, çmimi i kuotës është rritur me **+0.17%** gjatë muajit Shtator. **Kthimi vjetor neto për periudhën 30 Shtator 2020 – 30 Shtator 2021 është 2.18%.**


Fondi Prestigj ka të njëjten strukturë të portofolit të investimeve duke përqendruar investimet në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Për pasoje vlera e portofolit të investimit dhe norma e kthimit pesojnë luhajtje sa here ka ndryshime në kushtet e tregut, sic janë ndryshime të normave të interesit të bonove / obligacioneve të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulët dhe për rrjedhojë ulët dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Në këtë mënyrë çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm. Luhatshmeria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi i saj është i pamundur, kështu çmimi i kuotës mund edhe të bjere, jo vetëm të rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Prestigj



Ne dt 30 Shtator 2021	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (1 Mars 2012)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	2.18%	1.86%	2.08%	2.68%	4.00%	4.17%	4.81%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investitorët e fondit Prestigj dhe të gjithë fondetve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.